



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 2345 Prot.

Fier, më 21.02.2025.

PROJEKT VENDIM  
Nr. 23, datë 21.02.2025

**Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Vlashi Guxo, lagjia "8 Shkurti", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 08.02.2025.**

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", neni 8 dhe 16 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 08.02.2025, shkresës zyrtare nr.221/1.prot, datë 19.02.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Vlashi Guxo dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **300 300 (treqind mijë e treqind) lekë**, dhe në konstruksion banese në vlerën **166 995 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 54, shkronja "g",

**PROPOZON:**

1. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **300 300 (treqind mijë e treqind) lekë**.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **83 497 (tetëdhjetë e tre mijë katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Vlashi Guxo është në masën **383 797 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

**Drejtoria e Mbrojtjes Civile**  
Nasip BANI

**Drejtoria Juridike**  
Esmeralda KAPLLANAJ

**Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.**  
Pranvera ÇINA

**KRYETARI**  
Armando SUBASHI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZËVENDËS KRYETAR**

Vasil BREGU

